



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE
PA1 Nr. 08-153
08.05.2025
Shkup

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 1 dhe nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹ të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 69, paragrafët (1) dhe (4), nenit 70, paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, nenit 71, nenit 74, nenit 79, nenit 80 dhe nenit 81 nga Ligji i njëjtë, nenit 15, paragrafi (1), nënparagrafi 1, nenit 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 dhe nenit 51, paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i konsoliduar) nr. ark. 01-3732/1, datë 29.7.2019, dhe në lidhje me Kërkesën për shpallje të konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës nga pala e interesuar, Ensar Alushi (nr. ark. 08-432/1, datë 29.1.2025), Njoftimin nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike, nr. ark. 0805-376/2, datë 12.2.2025 (nr. ynë ark. 08-432/3, datë 24.02.2025), Studim për përcaktimin e arsytimit (studim fizibiliteti) për shpallje të konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës (nr. ark. 03-1927/1, datë 29.4.2025) dhe Konkluzionin nr. ark. 02-1997/4, datë 8.5.2025, në seancën e 19-të mbajtur më 8.5.2025, miratoi si vijon:

VENDIM
për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes
për transmetim në radio të shërbimit programor
në nivel lokal

1. Shpallet konkursi publik për dhënie e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, për shërbim programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm kryesisht informativ, në gjuhën shqipe dhe maqedonishte, dhe do të transmetohet përmes radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AKE), përkatësisht: 104.2 MHz.

2. Leja do të ndahet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i bartet personi tjetër.

3. Kandidatët në konkurs duhet të përmbushin kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike, të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënie e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i konsoliduar) nr. ark. 01-3953/1, datë 31.10.2023, që janë shpjeguar dhe specifikuar në dokumentacionin e konkursit.

4. Karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga AKE në pajtim me Ligjin e Komunikimeve Elektronike ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18 dhe 21/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 98/19, 153/19, 92/21, 222/24 dhe 59/25) dhe dispozitat e miratuara në bazë të Ligjit, janë shpjeguar dhe specifikuar në dokumentacionin e konkursit për miratimin për shfrytëzim të radiofrekuencave të dhënë nga AKE.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

5. Aplikimet e dorëzuara për konkurs, Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) do të vlerësohen në bazë të kriterëve në vijim, sipas mënyrës së mëposhtme të pikëzimit:

1. Përfaqësimi i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production), gjatë javës		17 pikë
• deri në 50% të pjesës folëse të programit	10 pikë	
• mbi 50% të pjesës folëse të programit	17 pikë	
2. Cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjeve		17 бода
• nga 3 deri në 5 lloje programesh në pjesën folëse të programit	10 pikë	
• mbi 5 lloje programesh në pjesën folëse të programit	17 pikë	
3. Përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare		17 pikë
• programe që nxisin zhvillim dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, të transmetuara në nivel vjetor		
• deri në 15 orë gjatë vitit	5 pikë	
• mbi 15 orë gjatë vitit	9 pikë	
• muzikë instrumentale nga autorë maqedonas dhe muzikë vokale dhe/ose muzikë vokale-instrumentale në gjuhën shqipe dhe maqedonase të transmetuar gjatë ditës		
• deri në 30% nga totali i muzikës së transmetuar	5 pikë	
• mbi 30% nga totali i muzikës së transmetuar	8 pikë	
4. Përfaqësim të informacioneve dhe përmbajtjeve nga pjesa folëse e programit me rëndësi për zonën, në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjatë javës		10 pikë
• nga 3 deri në 5 orë nga pjesa folëse e programit	5 pikë	
• mbi 5 orë nga pjesa folëse e programit	10 pikë	
5. Numri dhe struktura e punonjësve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë (së paku 2 (dy) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune me orar të plotë)		7 pikë
• 2 punonjës	5 pikë	
• mbi 2 punonjës	7 pikë	
6. Kushtet teknike për prodhimin e programeve		7 pikë

7. Koha e ofruar e programit të transmetuar ditor		7 pikë
• nga ora 10 deri në ora 17	4 pikë	
• mbi 17 orë	7 pikë	
8. Kushtet hapësinore për kryerje të veprimtarisë		7 pikë
9. Garancinë e ofruara për aftësinë financiare për kryerje të veprimtarisë		7 pikë
10. Afati i ofruar për fillim me kryerje të veprimtarisë		4 pikë
• deri në 3 muaj nga dita e dhënies së lejes	4 pikë	
• mbi 3 muaj nga dita e dhënies së lejes	2 pikë	
Në total		100 pikë

6. Për lejen e transmetimit në radio paguhet kompensim vjetor për çdo vit aktual, duke filluar nga data e dhënies së lejes, në llogari të Agjencisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia.

Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit të lejes, përcaktohen nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.185/14), Rregulloren për format e shërbimeve programore të transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14) dhe Rregulloren për zonat e transmetimit të shërbimeve programore televizive dhe radio ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14).

7. Për shfrytëzimin e radiofrekuencave paguhet kompensim vjetor në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike dhe Rregulloren për mënyrën e llogaritjes së kompensimit vjetor për shfrytëzimin e radiofrekuencave të AKE ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.192/21 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.192/24).

Kompensim për shfrytëzim të radiofrekuencave paguhet në llogari të AKE për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për shfrytëzim të radiofrekuencave.

8. Për përcaktimin e frekuencës së transmetuesit, mikrolokacionit, fuqisë maksimale efektive të rrezatimit (ERP), drejtimit të sistemit të antenës, si dhe për parametra të tjerë teknikë që nuk përcaktohen me këtë Vendim dhe me dokumentacionin e konkursit, kandidatët janë të detyruar (pas tërheqjes së dokumentacionit nga Agjencia dhe marrjes së vërtetimit nga Agjencia për dokumentacionin e tërhequr) të drejtohen në AKE, ku do t'i marrin parametrat e saktë teknikë, që janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të konkursit dhe sipas të cilit do të duhet të përpilohet raporti teknik për pjesën e transmetimit.

Aplikimi i kandidatëve në AKE duhet të jetë me të njëjtin emër si në Agjencinë.

9. Kandidatët për konkurs paraqesin aplikime në formular të veçantë, ku forma dhe përmbajtja përcaktohet nga Agjencia, dhe publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

Dokumentacionin për konkurs dhe formulari – Aplikacioni për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, mund të merren në arkivin e Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr. "Makedonija" nr. 38, Shkup, çdo ditë pune nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

Për dokumentacionin paguhet kompensim vjetor në shumë prej 60.000,00 (gjashtëdhjetë mijë) denarë në xhirollogari: 300000000618023 të Agjencisë, Banka depozituese: Banka Komerciale SHA Shkup.

10. Aplikacioni dorëzohet në zarf të mbyllur në Agjencinë, Pallati "Panko Brashnarov", rr. "Makedonija" nr. 38, Shkup, shënuar si vijon², përkatësisht:

- në këndin e sipërm majtas të zarfit të mbyllur duhet të shënohet "MOS E HAP",
- në mesin e zarfit të mbyllur të shënohet "Aplikim për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës".

Formularët dhe shtojcat ndaj Aplikimit për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, duhet të sistemohen sipas radhës dhe numrit rendor të formularit, përkatësisht shtojcë ndaj aplikimit, ku për çdo shtojcë ndaj aplikimit, në faqen e pare në këndin e sipërm djathtas të listës të shënohet numri rendor përkatës (Për shembull: Shtojcë nr. ____).

Aplikacioni, me dokumentacionin shoqërues nga neni 73, paragrafi (3) të LSHMAAV, dorëzohet në 2 (dy) kopje (origjinale dhe kopje).

11. Aplikacioni mund të dërgohet me postë rekomanduese ose me dorëzim në arkivin e Agjencisë.

12. Aplikacioni dorëzohet në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve fillon nga dita e parë pas publikimit të këtij Vendimi në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

Aplikimet dorëzohen në afatin e përcaktuar me këtë Vendim në mënyrë, formë, numër të kopjeve dhe me përmbajtje të parashikuar në Dokumentacionin e Konkursit.

Aplikimet e kandidatëve që nuk do të paguajnë kompensim për dokumentacionin, që do të dorëzohen pas përfundimit të afatit të përcaktuar me këtë Vendim, aplikimet e pakompletuara (që nuk do t'i përmbajnë të gjitha dokumentet dhe shtojca në pajtim me Aplikacionin), aplikimet e plotësuar në mënyrë të parregullt, si dhe aplikimet që nuk do të dorëzohen në 2 (dy) kopje (origjinale dhe kopje), nuk do të shqyrtohen.

Informacione shtesë, në lidhje me konkursin e shpallur publik, mund të merren nga personat në vijim:

- për konceptin programor: mr. Ognen Nedelkovski telefon celular: 072/212-686 dhe e-mail adresë: o.nedelkovski@avmu.mk; Nesrin Mahmut telefon celular: 075/452-531 dhe e-mail adresë: n.sejfula@avmu.mk;

- për strukturën pronësore dhe kushtet kadrovike: Katerina Donevska telefon celular: 075/452-543 dhe e-mail adresë: k.mitre@avmu.mk;

- për kushtet teknike dhe hapësinore: mr. Arben Saiti telefon celular: 076/203-222 dhe e-mail adresë: arben.saiti@avmu.mk;

- për kushtet financiare: Goran Radunoviq telefon celular: 071/223-219 dhe e-mail adresë: g.radunovic@avmu.mk; Vesna Simonovska telefon celular: 076/344-198 dhe e-mail adresë: v.simonovska@avmu.mk dhe

- për të dhëna të përgjithshme dhe çështje juridike: mr. Ivona Mufisheva telefon celular: 076/496-803 dhe e-mail adresë: i.mufiseva@avmu.mk dhe mr. Sanja Filipovska telefon celular: 078/329-139 dhe e-mail adresë: s.filipovska@avmu.mk.

13. Aplikacionet që do të dorëzohen në këtë konkurs publik, do të hapen publikisht, në selinë e Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr. "Makedonija" nr. 38, Shkup, një javë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve, përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi.

Informacionin për ditën dhe orën e hapjes publike do të publikohen në ueb faqen e Agjencisë: www.avmu.mk.

14. Vendimi për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës, do të miratohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e mbajtjes së hapjes publike të aplikacioneve, përcaktuar në pikën 13 të këtij vendimi.

Kandidatët e konkursit do të njoftohen për vendimin e dhënies së lejes, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e miratimit.

15. Ky vendim publikohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së, në ueb faqen e Agjencisë dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra gazetë ditore është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

A r s y e t i m

² Nëse parashtruesit e aplikimeve për pjesëmarrje në konkurs publik nuk përmbahen ndaj kushteve të përcaktuara në pikën 10. të këtij Vendimi, Agjencia nuk mban përgjegjësi për vonesën ose hapjen e parakohshme të Aplikimit.

Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) më 29.1.2025, është dorëzuar Kërkesë, nr. ynë ark.08-432/1, datë 29.1.2025, nga pala e interesuar, personi fizik Ensar Alushi nga Struga, për dhënien e lejes për hapje të radios lokale në zonën e komunës së Strugës.

Agjencia, në pajtim me nenin 70, paragrafi (4) të LSHMAAV, dhe me rastin e lëndës Kërkesë, nr. ynë ark.08-432/2, datë 4.2.2025, iu drejtua AKE ku është kërkuar informacion nëse ka frekuencë të lirë në zonën e komunës së Strugës, dhe nëse ka – dhe informacion për parametrat bazë teknike në bazë të cilit do të përpilohet zgjidhje teknike për transmetim të programit në radio.

Me datë 24.2.2025, AKE drejtuar Agjencisë dorëzoi Njoftim në lidhje me kërkesën për informacion për frekuencë të lira për transmetim të programit në radio në nivel lokal për qytetin e Strugës, ark.nr. 0805-376/2, datë 12.2.2025 (nr. ynë ark.08-432/3, datë 24.2.2025), se në bazë të ndarjeve ekzistuese, analizave të radioshtirjes dhe mjeteve në rajonin e qytetit të Strugës, parametrave bazë teknike sipas të cilit duhet të përpilohet zgjidhja teknike për mbulimin e qytetit të Strugës janë si në vijim: Vendndodhja e mundshme e transmetuesit: Vishni, Fuqia e rrezatimit efektiv: 500 W dhe Frekuencë: 104.2 MHz.

Në nenin 70, paragrafi (4) të LSHMAAV është paraparë se nëse në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, përcaktohet se ka radiofrekuencë të lira, agjencia do të përpilojë studim që do të konstaton arsyetimin për shpallje të konkursit publik, dhe veçanërisht nga aspekti i përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, si dhe nga aspekti i nevojave të publikut.

Rrjedhimisht, Agjencia përpiloi Studim për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Strugës (nr. ark. 03-1927/1, datë 29.4.2025), që është publikuar në ueb faqen e Agjencisë më 29.4.2025.³ Në Studim u konkludua si vijon: "Program në radio në Strugë transmeton vetëm një radiostacion (RA Plej), i cili pjesën folëse të programit e transmeton në gjuhën maqedonase. Sipas regjistrimit të fundit të popullatës të RMV-së, që është realizuar në vitin 2021, mbi gjysma e popullatës së Strugës (50,58% ose në numër absolut 25.785 banorë) janë të përkatësisë etnike shqiptare. Për këto arsye, duke pasur parasysh se Struga është një nga komunat me potencial më të madh në treg (numri i subjekteve afariste aktivë është 2.232), është e nevojshme t'i japë leje në radiostacion që do t'i plotësojë nevojat programore të kësaj popullate. Dy radio stacionet që transmetojnë program në gjuhën shqipe në Strugë kanë ndërprerë me transmetim të programit (RA Rapi në vitin 2024 dhe RA Drini në vitin 2020). Për të mundësuar kushte për funksionim më të mirë, kryesisht përmes qasjes për një pjesë më të madhe të publikut dhe qasje për një numër më të madh reklamuesish, leja duhet të jepet për transmetim të programit në gjuhën shqipe dhe maqedonishte. Pra, konkluzioni është se ka arsyetim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në zonën e Komunës së Strugës, për shërbim programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën shqipe dhe maqedonishte. Kjo do të thotë se nga 15% deri në 25% e totalit të programit të transmetuar gjatë një jave, pa kohën e caktuar për përmbajtjet që nuk i nënshtrohen klasifikimit, duhet të jenë përmbajtje folëse, që përmbushin kryesisht funksion informues që nuk duhet të përfaqësohet më pak se 50% dhe as më shumë se 65% në pjesën folëse të programit gjatë një jave."

Rrjedhimisht, sipas të lartpërmendurës, dhe duke pasur parasysh se në pajtim me Planin për ndarjen dhe shfrytëzim të radiofrekuencave, është konstatuar se ka radiofrekuencë të lirë për komunën e Strugës, dhe sipas Studimit, nr. ark. 03-1927/1, datë 29.4.2025, është konstatuar arsyetimi për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në zonën e Komunës së Strugës, përkatësisht për shërbim programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm kryesisht informative, në gjuhën shqipe dhe maqedonishte, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 1 dhe nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 69, paragrafët (1) dhe (4), nenit 70, paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, nenit 71, nenit 74, nenit 79, nenit 80 dhe nenit 81 nga Ligji i njëjtë, nenit 15, paragrafi (1), nënparagrafi 1, nenit 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 dhe nenit 51, paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Konkluzionin ark.nr.02-1997/4 datë 08.05.2025, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 19-të mbajtur më 8.5.2025, miratoi Vendim si në dispozitiv, dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së, në ueb faqen e Agjencisë, dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**

³ [Studim-për-fizibilitetin-e-arsyetimit-për-shpallje-konkurs-publik-për-radio-në-Strugë.pdf](#)